

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6235  
E martë, 9 shkurt 2021  
çmimi 0.40

6 791 raste aktive me  
Covid në Kosovë FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR ABBRUCH GMBH**  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

SHKRIM I SERGE MÉTAIS LIDHUR ME PROCESIN GJYQËSOR  
KUNDËR UÇK-SË NË HAGË FAQE 4-5

# TË RIKTHEHET PROCESI NË PRISHTINË



Shkruan: Serge  
MÉTAIS

PZAP-i  
dënon me  
16 700 euro  
disa parti  
politike



MOSZBATIMI I DISA REFORMAVE INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS  
U KA KUSHTUAR ME HUMBJE TË DISA MILIONË EUROVE

# EPIK-u: KOSOVA HUMBI 7.5 MILIONË EURO TË FONDEVE TË BE-së

Instituti EPIK ka treguar se institucionet e Kosovës kanë humbur 7.5 milionë euro fonde nga Bashkimi Evropian si pasojë e moszbatimit të disa reformave. Ky institut ka vlerësuar se Kosova është dashur t'i zbatojë 23 reforma të parapara në Marrëveshjen e Financimit për Programin e Veprimit, por deri më tani janë zbatuar vetëm tetë prej tyre. Sipas EPIK-ut, humbja e këtyre fondeve është indikator i mungesës së theksuar të vullnetit politik dhe të kapaciteteve administrative për zbatimin e reformave evropiane FAQE 3



## OPINION

PËRPJEKJE PËR RISHKRIM TË  
HISTORISË NGA ATA QË NUK E  
KANË BËRË HISTORINË! F. 11

Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA



## AKTUALE



MJEKËSIA NUKLEARE NË QKUK,  
ME SHËRBIME TË REJA F. 6

## AKTUALE



QEVERIA E RE DUHET  
TË FORMOJË NJË TRUP  
TË VEÇANTË PËR PARTNERITET  
ME IZRAELIN F. 8

MARRËVESHJA SHBA - KOSOVË  
KRIJON VENDE PUNE F. 8

## SPORT

NIKA: PRISHTINA, E GATSHME  
TA ELIMINOJË DRITËN F. 12

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
[info@kolegji.biznesi.com](mailto:info@kolegji.biznesi.com)  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Rusia dëbon një diplomate shqiptare

**TIRANË, 8 SHKURT** - Rusia ka dëbuar diplomaten shqiptare Jonida Drogu nga Moskë si një kundërpërgjigje ndaj dëbimit të një diplomati rus nga ana e Tiranës. Njoftimi është bërë nga ana e Ministrisë së Jashtme të Rusisë, e cila tha se sekretarja e parë e Ambasadës së Shqipërisë në Moskë është shpallur person i padëshiruar (non grata). Ajo është urdhëruar që ta lëshojë vendin brenda 72 orësh.

“Më 8 shkurt ambasadori shqiptar në Rusi, Arben Gazioni, është thirrur në Ministrinë e Jashtme dhe është njoftuar me letrën ku Sekretarja e Parë e ambasadës shqiptare është shpallur person non grata”, thotë Ministria e Jashtme e Rusisë, bëjnë me dije mediat ruse.

Në njoftim thuhet se ky hap është marrë si përgjigje ndaj vendimit të Shqipërisë për ta dëbuar Sekretarin e Parë të Ambasadës së Rusisë në Tiranë “me pretekste të trilluara”.

Ministria e Jashtme e Rusisë, mes të tjerash, thotë se veprimet e Tiranës do t'i dëmtojnë marrëdhëniet e dy vendeve. “Veprimet shqiptare kundërshtojnë pretendimet e Tiranës me synimin për të zhvilluar marrëdhënie miqësore midis vendeve tona dhe në mënyrë efektive shtojnë prapa perspektivën e kapërcimit të ngecjes në marrëdhëniet dypalëshe. Një mospërputhje e tillë është për të ardhur keq”, shtoi Ministria e Jashtme.

Më shumë se dy javë më parë autoritetet shqiptare dëbuan

sekretarin e parë të Ambasadës së Rusisë në Tiranë pasi, siç thanë, që nga muaji prill i vitit 2020 ky diplomat ka shkelur në mënyrë të “përsëritur” kufizimet e vendosura për ta parandaluar përhapjen e koronavirusit. Ministria e Jashtme e Shqipërisë në arsyetimin e saj pati thënë se çështja e shkeljes së masave të kufizimit ishte adresuar tek ambasadori i Rusisë në Tiranë, por diplomati rus kishte vazhduar të mos i përfillte ato.

Pas kësaj mase të Tiranës, kishte reaguar Ministria e Jashtme e Rusisë, duke e cilësuar këtë vendim “provokim”. Rusia pretendoi se diplomati i saj u dëbua përmes një “arsyetimi tërësisht të sajuar”.



Rusia akuzoi autoritetet shqiptare se po “bashkëpunojnë me forcat kundër Rusisë”, në prag të mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare në muajin prill. Edhe në vitin 2018 Shqipëria kishte dëbuar dy diplomatë rusë. Në atë kohë ishte thënë

se aktivitetet e tyre nuk ishin në përputhje me statusin e tyre diplomatik.

Tirana dhe Moskë rivendosën raportet diplomatike më 1991, 30 vjet pasi regjimi komunist i Shqipërisë kishte prishur lidhjet e ngushta që kishte me Rusinë.

## Çmimet e naftës kthehen në nivelet e para pandemisë

**LONDËR, 8 SHKURT** - Çmimet e naftës janë rikuperuar në nivelet e para pandemisë së koronavirusit, e cila ka qenë shkatërruese për industrinë e “arit të zi”.

Nafta e papërpunuar Brent, që përdoret si standard ndërkombëtar, u rrit të hënën në Londër për 1.26 për qind, përkatësisht në 60.19 dollarë për fuçi.

West Texas Intermediate (WTI), standardi për naftën amerikane, javën e kaluar u rrit mbi 55 dollarë për fuçi - për herë të parë në më shumë

se një vit.

Kërkesa për naftë është akoma më e ulët se normalja, por çmimi jep shpresë për një rimëkëmbje ekonomike më të shpejtë seç pritej më parë.

Kërkesa nga kompanitë ajrore ka pësuar rënien më të madhe për shkak të kufizimeve në udhëtim, të vendosura për frenimin e përhapjes së koronavirusit.

Trafiku ajror i pasagjerëve ka rënë për 70 për qind një vit më parë.

Por, kufizimet në udhëtim kanë rritur kërkesën për naftë

në fusha të tjera, siç është tregtia elektronike.

Konsumatorët janë duke blerë më shumë në internet dhe, në këtë mënyrë, kanë rritur kërkesën për karburante për t'i furnizuar kamionët dhe anijet e mallrave.

Ndër faktorët kryesorë që kanë çuar në rritje të çmimeve janë edhe përpjekjet e vendeve prodhuese të naftës, sidomos të Arabisë Saudite, për ta kufizuar prodhimin. Që kur kanë rënë dakord për zvogëlimin e prodhimit, prillin e kaluar, prodhuesit



kanë parandaluar grumbullim duke çuar në ulje të e 2.1 miliardë fuçive naftë, rezervave.

## Netanyahu deklarohet i pafajshëm për akuzat për korrupsion

**JERUSALEM, 8 SHKURT** - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, u deklarua i pafajshëm për akuzat për korrupsion. “E konfirmoj përgjigjen me shkrim të paraqitur në emrin tim”, tha Netanyahu të hënën para gjykatës në Jerusalem.

Ai u referua një dokumenti që avokatët e tij ia kanë dhënë gjykatës.

Në të avokatët kanë

argumentuar se Netanyahu nuk është fajtor për akuzat për ryshfet, thyerje të besimit dhe mashtrim.

Netanyahu akuzohet për pranimin e dhuratave nga miqtë e pasur dhe për kërkimin e favoreve për manjatët e mediave, në këmbim të një mbulimi më të favorshëm.

Ai e ka cilësuar ndjekjen e tij penale si gujeti shtrigash.

Gjykimi ka nisur nëntë muaj më herët, por është shtyrë vazhdimisht për shkak të masave kundër koronavirusit.

Në atë kohë, Netanyahu ka formuar koalicionin qeveritar me rivalin e tij në zgjedhje, Benny Gantz, por ai koalicion është prishur në dhjetor.

Si rezultat, Izraeli do t'i mbajë zgjedhjet parlamentare më 23 mars - të katërtat të tilla në më pak se dy vjet.



## Senati nis sot gjyqin kundër Trumpit

**WASHINGTON, 8 SHKURT** - Senati amerikan nis të martën gjykimin e ish-presidentit republikan të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump. Trump akuzohet për “nxitje të kryengritjes” më 6 janar. Atë ditë mbështetësit e tij kanë sulmuar ndërtesën e Kongresit Amerikan, në përpjekje për ta

penguar certifikimin e fitores së Joe Bidenit në zgjedhjet presidenciale të 3 nëntorit. Pesë njerëz, përfshirë një polic, kanë vdekur në trazira. Sipas një sondazhi të kryer nga “ABC News” dhe Qendra e Kërkimeve “Ipsos”, shumica e amerikanëve - 56 për qind - duan që Senati amerikan ta

dënojë Trumpin dhe, në këtë mënyrë, ta ndalojë atë të udhëheqë ndonjë zyrë publike në të ardhmen. Megjithatë, 50 demokratët e Senatit do të kenë nevojë për votat e së paku 17 republikanëve për ta dënuar ish-presidentin. Ky rezultat duket se nuk ka gjasa të arrihet.



Moszbatimi i disa reformave institucioneve të Kosovës u ka kushtuar me humbje të disa milionë eurove

## EPIK-u: Kosova humbi 7.5 milionë euro të fondeve të BE-së

Instituti EPIK ka treguar se institucionet e Kosovës kanë humbur 7.5 milionë euro fonde nga Bashkimi Evropian si pasojë e moszbatimit të disa reformave. Ky institut ka vlerësuar se Kosova është dashur të zbatojë 23 reforma të parapara në Marrëveshjen e Financimit për Programin e Veprimit, të cilat deri më tani janë zbatuar vetëm tetë prej tyre. Sipas EPIK-ut, humbja e këtyre fondeve është indikator shqetësues i mungesës së theksuar të vullnetit politik dhe kapaciteteve administrative për zbatimin e reformave evropiane

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

**PRISHTINË, 8 SHKURT** - Instituti EPIK ka bërë me dije se Kosova ka humbur 7.5 milionë euro të fondeve të Bashkimit Evropian nga moszbatimi i reformave. Përmes një njoftimi për media, ky institut ka vlerësuar se institucionet e Kosovës është dashur të zbatojnë 23 reforma të parapara në marrëveshjen e Financimit për Programin e Veprimit, të cilat deri më tani janë zbatuar tetë reforma. “Në dhjetor 2017 Kosova dhe Bashkimi Evropian nënshkruan Marrëveshjen e Financimit për Programin e Veprimit për Kosovën për vitin 2016 - Pjesa II - Mbështetja Sektoriale Buxhetore. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, Kosova ka marrë për obligim që t’i zbatojë reformat në fushën e administratës publike, në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) dhe Agjendën Evropiane të Reformave (ERA), drejt krijimit

të një administrate publike të pavarur, profesionale dhe në shërbim të qytetarit. Institucioni përgjegjës për koordinimin e zbatimit të marrëveshjes është Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike”, ka vlerësuar EPIK.

Sipas marrëveshjes, institucionet e Kosovës janë zotuar se gjatë viteve 2018-2020 do të zbatojnë 8 reforma në fushën e administratës publike, të cilat do të vlerësohen me anë të 33 indikatorëve. Ndërsa Bashkimi Evropian ishte zotuar se zbatimin e reformave do të shpërblejë me 22 milionë euro të mbështetjes direkte buxhetore përmes katër transeve financiare në vlerë prej 5.5 milionë eurosh secila. “Thënë ndryshe, institucionet e Kosovës përmes zbatimit të këtyre reformave do të fitonin 22 milionë euro të cilat do të mund të orientoheshin për përkrahjen financiare të bizneseve, për ofrimin e bursave për studentët, për ndërtimin e shkollave, të spitaleve apo çfarëdo shërbimi

tjetër publik në të mirën e qytetarëve”, ka bërë me dije EPIK-u, duke shtuar se në vitin 2018 Kosova ka pasur për të përmbushur dymbëdhjetë indikatorë, në vitin 2019 njëmbëdhjetë indikatorë dhe në vitin 2020 dhjetë indikatorë. “Gjatë gjithë kësaj kohe institucionet e Kosovës është dashur të sigurojnë përmbushjen e katër parakushteve. Në këtë kontekst, transhi i parë prej 5.5 milionë eurosh nuk ka qenë i kushtëzuar me indikatorë dhe rrjedhimisht është zbatuar në tërësi. Transhi i dytë është zbatuar në vlerë prej 3.11 milionë eurosh pasi që institucionet e Kosovës kishin përmbushur 7 nga 12 indikatorë

variabël. Transhi i tretë është zbatuar në vlerë prej vetëm 0.42 milionë eurosh pasi që institucionet e Kosovës kishin përmbushur vetëm 1 nga 11 indikatorë variabël”, ka treguar instituti.

Ndër të tjera, EPIK-u ka treguar se në këtë proces ka ndikuar edhe pandemia Covid-19. “Transhi i katërt është shtyrë për vitin 2021 për shkak të efekteve të pandemisë. Pra, sipas marrëveshjes, deri më sot institucionet e Kosovës është dashur t’i zbatojnë 23 reforma specifike që t’i fitojë 16.5 milionë euro përkrahje drejtpërdrejt buxhetore nga fondet e BE-së. Por, institucionet kanë zbatuar vetëm 8 reforma specifike dhe

kanë fituar 9.03 milionë euro, duke humbur kështu 7.47 milionë euro nga fondet e BE-së”, është thënë në njoftimin e EPIK.

Humbjen e këtyre fondeve EPIK e ka vlerësuar shqetësuese. “Humbja e radhës e fondeve të BE-së është indikator shqetësues i mungesës së theksuar të vullnetit politik dhe kapaciteteve administrative për zbatimin e reformave evropiane dhe paralajmërim për vështirësitë në të cilat Kosova do të hasë në zbatimin e IPA III për vitet 2021-2027, ku vetëm do të ashpërsohen kërkesat për performancë për shfrytëzimin e fondeve të BE-së”, ka bërë me dije ky institut.

## PZAP-i dënon me 16 700 euro disa parti politike

**PRISHTINË, 8 SHKURT** - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka vendosur për nëntë ankesa të shkeljeve që janë bërë gjatë fushatës zgjedhore nga subjektet politike. Nga nëntë ankesa, gjashtë nga to janë pranuar si të bazuara.


Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është dënuar 10 700 euro, Partia Demokratike e Kosovës është dënuar 2 000 euro, kurse Lidhja Demokratike e Kosovës 4 000 euro. “Natyra e shkeljeve ka qenë përdorimi i aseteve dhe objekteve publike gjatë fushatës zgjedhore. Vendosja e billbordeve në hapësirat e subjekteve të tjera, përdorimi i personave të mitur

gjatë fushatës dhe vendosja e posteve në rrugë publike”, ka thënë Mul Desku, kryesues i Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

Ankesat në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) janë dërguar nga organizata “Birn” dhe Partia Demokratike e Kosovës.


Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është institucion i pavarur, përgjegjës për të vendosur për ankesat dhe apelet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor. Fushata për zgjedhjet e parakohshme parlamentare që do të mbahen më 14 shkurt zyrtarisht ka filluar më 3 shkurt.





SHKRIM I SERGE MÉTAIS LIDHUR ME PROCESIN GJYQËSOR KUNDËR UÇK-SË NË HAGË

# TË RIKTHEHET PROCESI NË PRISHTINË



Shkruan: Serge MÉTAIS

Gjykata e Posaçme për Kosovën së fundmi i hodhi poshtë kërkesat për lirim me kusht për Hashim Thaçin e të

bashkakuzuarit e tij. Në stadin e sotëm, vendosmëria që ajo po tregon është shqetësuese. Ka rrezik që mekanizmi gjyqësor i ngritur në Hagë të shndërrohet së shpejti në mekanizëm djallëzor. A ka ende kohë për ta ndaluar? Sado që mund të duket e çuditshme, përgjigjja është se po. Gjykatën e Posaçme e ka krijuar Kuvendi i Kosovës dhe po ai mund të vendosë për fatin e saj: Çfarë është bërë me ligj mund të zhbëhet me ligj. Ky Kuvend e ka

në dorë që ta rikthejë procesin në Prishtinë.


Për ta kuptuar më mirë këtë sfidë, është e udhës të saktësojmë që Gjykata e Posaçme për Kosovën nuk është një gjykatë penale ndërkombëtare:

- Ajo nuk është krijuar përmes ndonjë rezolute të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara si në rastin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (GjPNJ), e cila

ishte e detyrueshme për të gjithë qytetarët e shteteve të dala nga Jugosllavia (Serbisë, Kroacisë, Sllovenisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi);

- Ajo nuk është krijuar as përmes ndonjë traktati ndërkombëtar si në rastin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (GjPN) e cila bazohet në një traktat të quajtur "Statuti i Romës" e të hyrë në fuqi më 2002. Ajo ka

për detyrë t'i gjykojë personat e akuzuar për krime lufte, krime kundër njerëzimit ose gjenocid dhe është sot i vetmi juridiksion penal ndërkombëtar i përhershëm dhe me prirje të përbotshme. Gjykata e Posaçme është krijuar, në fakt, vetëm nëpërmjet ligjit të votuar nga Kuvendi i Kosovës më 2015 (nenit 162 të Kushtetutës dhe Ligjit nr. 05/L-053 "për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar").



Ajo është pra një institucion gjyqësor i Republikës së Kosovës... i zhvendosur në Hagë.

Kjo krijesë shumë origjinale shpjegohet vetëm me emocionet që ngjalli raporti Marty, i miratuar në mënyrë masive nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në janar 2011. Pretendimet për trafik organesh njerëzore, që përmbante raportin, ishin me natyrë tejet çnderuese për rezistencën shqiptare: disa robërve serbë u qenkëshin hequr organe të cilat qenkëshin "eksportuar" pastaj përmes aeroportit të Tiranës për t'ua vendosur pritësve jashtë shtetit. Raporti hedh mendimin se kjo paskësh ndodhur me qindra herë. Krimi qenkësh i përbindshëm. Shumë tmerre ishin parë tashmë gjatë luftërave në ish-Jugosllavi, si masakra e Srebrenicës, e kryer nga serbët

dhe e cilësuar si gjenocid nga GjPNJ-ja. Mirëpo kësaj radhe do të shihnim që edhe shqiptarët nuk mbetkëshin prapa në punë tmerri: Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) paskësh bërë tregti fitimprurëse me organe të marra nga robër serbë!

Raporti ishte, në të vërtetë, produkti i një prej operacioneve më të suksesshme të dezinformimit që prej shembjes së regjimeve komuniste. I kurdisur prej shërbimeve të fshehta serbe, ai mori një mbështetje vendimtare nga ana e shërbimeve ruse. Te një i zgjedhur zviceran, Dick Marty, ai gjeti një idiot të dobishëm mjaft efikas. Raporti i tij është një përmbledhje e hartuar me dhelpëri duke u nisur nga shënimet e shërbimeve të fshehta serbe si edhe nga dosjet e akuzave të GjPNJ-së ose të gjykatave të Kosovës. Pak rëndësi kishte që ato dosje nuk

kishin të bënin fare me trafik organesh njerëzore. I gjithë raporti Marty luan në thelb me sugjerimin, insinuatën ose probabilitetin.

Emocionet që ngjalli ky raport i shtynë Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të krijonin, në shtator 2011, një "Grup Pune të Posaçëm Hetimor" (Special Investigative Task Force). U ra dakord për të caktuar në krye të tij në prokuror amerikan, Clint Williamson. Në maj 2012, Kuvendi i Kosovës miratoi një ligj për bashkëpunimin me këtë grup pune, çka i dha mundësi këtij të fundit të kryente një hetim penal të pavarur rreth pretendimeve që përmbante raportin.

Më 29 korrik 2014, pas më shumë se dy vjet hetimi, prokurori Williamson, gjatë një konference për shtyp në Bruksel, deklaroi që trafiku i organeve nuk mund të vërtetohej veçse në "më pak se dhjetë raste". Ai shtoi: "Të ekzagjerohen shifrat ose të thuhet se çdo serb i vrarë apo i shpallur i zhdukur qenka bërë objekt i ndonjë heqjeje organesh nuk i shërben kurrfarë interesi, por vetëm sa shton dëshpërimin e familjeve të personave të humbur, sepse nuk ka asnjë provë të vetme".

Si nata me ditën në krahasim me ato qindra raste që sugjeronte raporti Marty! Dhe, domethënia e fjalëve "më pak se dhjetë" mund të ishte fare "zero". Mirëpo edhe kaq mjaftonte që aleatët amerikanë dhe evropianë të ndiheshin të detyruar që të ushtronin një trysni miqësore mbi udhëheqësit e Kosovës: këta duhej të votonin përmes Kuvendit të tyre një ligj për krijimin e Gjykatës së Posaçme. Mes klasës politike të Kosovës debati që i dhimbshëm sepse, thjesht, ideja që të votohej për krijimin e një gjykate të posaçme ishte e padurueshme. Por mesazhi që po u jepej ishte i qartë: ose votojeni ligjin e tregoni që nuk keni pse të trembeni lidhur me trafikun e organeve, ose mos pranoni dhe do të konsiderohet se jeni fajtorë për krimet e urryera që pretendohen në raportin e Martyt. Më në fund, me mbështetjen e pikërisht këtyre udhëheqësve që sot ndodhen të burgosur në Hagë, ligji për krijimin e Gjykatës së Posaçme u votua në Kuvendin e Kosovës me një shumicë prej dy të tretash.

Pikërisht kjo gjykatë e ka prodhuar aktakuzën kundër Hashim Thaçit dhe tre ish-udhëheqësve të tjerë të lartë të UÇK-së, të bërë publike më 4 nëntor të vitit të kaluar. Një aktakuzë tek e cila nuk gjen dot absolutisht asgjë lidhur me pretendime për trafik

organesh.

Vërtetohet kështu plotësisht që udhëheqësit e Bashkimit Evropian dhe amerikanët janë mashtruar keqas nga një operacion dezinformimi i përmasave të mëdha. Por, prapëseprapë, sukcesi i këtij bataçillëku mbetet i plotë.

Ai qëndron në vetë ekzistencën e Gjykatës së Posaçme. Si edhe në një aktakuzë që, ndonëse nuk përmban asgjë lidhur me trafike të pretenduara organesh, mund të çojë, megjithatë, në dënime shumë të rënda. Hashim Thaçi dhe tre ish-udhëheqësit e tjerë të UÇK-së, sot të burgosur në Hagë, akuzohen, në fakt, se paskan krijuar një "sipërmarrje të përbashkët kriminale". Sipas aktakuzës, ata "ngarkohen secili personalisht me përgjegjësi penale" për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të kryera nga kjo sipërmarrje gjatë luftës, më 1998-1999 dhe në vitin 2000. Aktakuza as që do t'ia dijë fare se ata vetë nuk paskan qenë veprues të drejtpërdrejtë të atyre krimeve, as se një pjesë e atyre krimeve qenkan gjykuar tashmë në suazë të disa juridiksioneve të tjera, GjPNJ-së apo gjykatave të Kosovës. Ajo që paraqitet si një "sipërmarrje kriminale" është organizata e Rezistencës, kurse ata që shihen si penalisht përgjegjës për krime që ajo paskësh kryer janë ish-udhëheqësit e saj.

E gjithë kjo është e papranueshme. Është e papranueshme jo sepse krimet e pretenduara në aktakuzë - keqtrajtim ndaj robërve, akte torture, ekzekutime pa gjyq, vrasje "tradhtarësh", "bashkëpunëtorësh me armikun" apo kundërshtarësh politikë të hamendësuar nuk paska sesi të jenë kryer nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe nuk u dashkan gjykuar. E papranueshme ajo është për dy arsye thelbësore.

E para është se ekzistenca e Gjykatës së Posaçme në Hagë nuk përlligjet dot përveçse me pretendimet për trafik organesh nga ana e raportit Marty. Mungesa në aktakuzë e trafikut të organeve e bën këtë gjykatë të papërligjur.

Arsyeja e dytë është se, duke gjykuar në Hagë, do të bëhej një padrejtësi. Gjykimi në Hagë do të nënkuptonte, faktikisht, që t'i jepet Gjykatës së Posaçme një status të cilin ajo nuk e ka: atë të një gjykate penale ndërkombëtare. Mirëpo, në një gjykatë të tillë nuk do të mund të gjykohej krimet e kryera nga Rezistenca shqiptare pa u gjykuar aty, gjithashtu, edhe krimet e kryera nga forcat e sigurisë, ushtria dhe paraushtarakët serbë në Kosovë. Krimet e

luftës dhe krimet kundër njerëzimit që ata kanë kryer janë mjaft të shumta, masive dhe të dokumentuara mirë. Lënda nuk mungon aspak për të ngritur një dosje akuze, madje edhe për krim gjenocidi. Sidomos tani, njëzet vjet pas përfundimit të luftës, kur gati një mijë trupa shqiptarësh të Kosovës, të zhdukur në vitet 1998-1999, janë zbuluar në disa varre masive në Serbi, dhe kur, së fundmi, janë gjetur përsëri trupa të tjerë në një minierë kripi në afërsi të Rashkës. Në qoftë se do të gjykohej vetëm njëra nga palët - ajo e sulmuara, Rezistenca - dhe nuk do të gjykohej pala tjetër - ajo agresore, fuqia pushtuese, atëherë do të bëhej një padrejtësi. Do të shkelej parimi i trajtimit të barabartë mes palëve, të cilin duhet ta respektojë çdo gjykatë penale ndërkombëtare.

Për këto arsye, por edhe për të ndalur atë që po shfaqet gjithnjë e më shumë si një mekanizëm djallëzor, duhet të merret një vendim: të mbyllet Gjykata e Posaçme dhe të transferohet dosja e akuzës në Kosovë. Këtë vendim, Kuvendi i Kosovës mund ta marrë. Nuk do të ishte fare fjala për të ndërprerë një procedurë gjyqësore. Thjesht, procesi që duhej të zhvendosej në Hagë, do të rikthehej në Prishtinë.

E mira do të ishte që nismën për këtë ta marrë Bashkimi Evropian. Ai mund të konsiderojë që përlligjet një kërkesë për transferim të dosjes së akuzës drejt gjykatave të zakonshme të Kosovës. Këtë mund ta bëjë përpara se Kuvendi i Kosovës të shprehet vetë dhe të shkaktojë një krizë me aleatët e tij evropianë e amerikanë.

Të pranohet që procesi të mbahet në Hagë do të ishte një padrejtësi (shkelje e parimit të trajtimit të barabartë të palëve në konflikt). Për Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, kjo do të ishte njëllloj sikur ata të vazhdonin të pranonin që t'i tërhiqnin nga hunda. Mbyllja e kësaj gjykate të posaçme do të ishte gjithashtu më i pakti ndër sanksionet që meritojnë autorët e këtij mashtrimi të madh.

*Serge Métais, autor i librit "Histoire des Albanais. Des Illyriens à l'indépendance du Kosovo (Histori e shqiptarëve. Nga ilirët deri te pavarësia e Kosovës)", botuar në Francë më 2006 nga shtëpia botuese "Fayard", përkthyer edhe në shqip dhe në bullgarisht. (Ky shkrim është botuar në "Mediapart" në Francë dhe është përkthyer në gjuhën shqipe nga Arben Leskaj)*

## 6 791 raste aktive me Covid në Kosovë

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 8 SHKURT - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 2 388 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 290 raste pozitive

me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar tri raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Gjilan një rast (53 vjeç), Klinë një rast (80 vjeç) dhe Rahovec një rast (73 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 62 548 raste nga 252 163 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 526 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 189 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 54 231 raste, kurse

numri i rasteve aktive është 6 791.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 120 raste, Prizren 25 raste, Gjakovë 19 raste, Pejë 19 raste, Podujevë 18 raste, Lipjan 16 raste, Fushë-Kosovë 9 raste, Ferizaj 8 raste, Obiliq 8 raste, Rahovec 8 raste, Vushtrri 7 raste, Gjilan 6 raste, Mitrovicë 6 raste, Suharekë 4 raste, Kamenicë 3 raste, Deçan 2 raste, Dragash 2 raste, Istog 2 raste, Klinë 2 raste, Shtime 2 raste, Viti 2 raste dhe me nga një rast komunat Kaçanik dhe Skenderaj.



## Mjekësia nukleare në QKUK, me shërbime të reja



PRISHTINË, 8 SHKURT (ER) - Në Klinikën e Mjekësisë Nukleare të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për herë të parë është aplikuar metoda me jod radioaktiv për trajtimin e pacientëve të cilët kanë probleme me gjëndrën tiroide (vetëm te pacientët me problemet me tireotoksikozë). Ky shërbim është aktivizuar pas licencimit të klinikës nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore (AKMRrSB).

Me fillimin e implementimit të metodës me jod radioaktiv, mjekësia nukleare ka kompletuar gamën rreth ofrimit të shërbimeve për problemet me gjëndrën tiroide.

Pas përmirësimit të situatës me pandeminë Covid-19 dhe furnizimit me materialin e nevojshëm, në mjekësinë nukleare ka filluar punën laboratorit i RIA, ku po punohen të gjitha llojet e analizave laboratorike për

gjëndrën tiroide si: T3, T4, TSH, AntTPO, AntTG dhe Tg.

Në vitin 2020, gjithashtu, kanë filluar edhe ekzaminimet për denzitometrinë e kockave - DEXA, një shërbim i nevojshëm për pacientët që kanë problem me osteoporozë (humbje të masës kockore), i cili i ka munguar QKUK-së. Në mjekësinë nukleare të QKUK-së nuk ka listë të pritjes dhe të gjithë pacientët marrin shërbimet e nevojshme mjekësore brenda javës.

## Emërohen anëtarët e komisioneve të përhershme të Këshillit Prokurorial të Kosovës

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 8 SHKURT - Këshilli Prokurorial i Kosovës, i drejtuar nga kryesuesi Jetish Maloku, ka zhvilluar takimin e 195 me radhë, nën masat e mbrojtjes nga pandemia dhe përmes komunikimit në distancë, në të cilën ka miratuar një sërë aktesh dhe veprimesh nga fushat e përgjegjësisë të tij. Ky takim ka filluar me

aprovimin e kërkesës së kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Prishtinës për vazhdimin e mandatit të Udhëheqësit të Departamentit të Përgjithshëm dhe atij për të Mitur në këtë prokurori.

Po në këtë takim janë emëruar anëtarët e katër komisioneve të përhershme të KPK-së si në vijim: Komisioni për Çështje Normative përbëhet nga: Armend Zenelaj, kryesues, Bahri Hyseni dhe Ilir Morina,

anëtarë. Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel përbëhet nga: Ariana Shajkovi, kryesuese, Haki Geci dhe Bedrie Sylja-Alshiqi, anëtarë. Komisioni për Administrimin e Prokurorisë përbëhet nga: Veton Shabani kryesues, Sevdije Morina dhe Jovo Radovic, anëtarë. Komisioni për Vlerësim të Performancës së Prokurorëve përbëhet nga: Ardian Hajdaraj, kryesues, Agron Qalaj dhe Enver Sokoli,

anëtarë. Takimi ka vazhduar me prezantimin e Planit të personelit administrativ për vitin 2021, i cili pas diskutimeve është aprovuar nga anëtarët e KPK-së.

Po në këtë takim para anëtarëve të KPK-së kanë prezantuar projektet e tyre që implementojnë në sistemin prokurorial të Kosovës partnerët nga Ambasada Amerikane, Zyra e BE-së në Kosovë dhe projekti i Mbretërisë së Bashkuar në

Kosovë. Në fund është mbajtur seancë dëgjimore për një rast disiplinor ndaj një prokurori të Prokurorisë Themelore të Prishtinës, me ç'rast është marrë vendimi përkatës, i cili do të bëhet publik pasi që të bëhet përfundimtar, ashtu siç është i përcaktuar me ligj, si dhe është vazhduar transferimi i përkohshëm për dy prokurorë, një në Prokurorinë Themelore të Gjakovës dhe një në atë të Mitrovicës.



Aktivitetet e partive politike në kuadër të fushatës së zgjedhjeve të 14 shkurtit

## Limaj merr përkrahje në Suharekë dhe Mitrovicë

**SUHAREKË, 8 SHKURT (ER)** - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, përmes një postimi në rrjetet sociale ka thënë se mbrëmë kanë marrë mbështetje masive në Duhël, Greikoc dhe Bllacë për zgjedhjet e 14 shkurtit. Sipas Limajt, kjo mbështetje është mesazh i qartë se kauza "Me Çlirimtarët" tashmë është i pranishëm në çdo familje të Komunës së Suharekës. "Kjo gatishmëri dhe vullnet i madh që po shohim çdo ditë në takime të ngrohta me bashkëluftëtarë, intelektualë e përkrahës të Nismës kudo nëpër Kosovë, na jep forcë e besim që kauzën tonë, zërin tonë mbrojtës për vlerat kombëtare ta çojmë deri në fitore. Me këtë përkrahje të madhe të Suharekës vlerat kombëtare do t'i mbrojmë më mirë dhe zëri i çlirimtarëve të 121-it do të dëgjohet si kurrë më parë në Kuvendin e Kosovës", ka thënë Fatmir Limaj, kryetar i Nismës Socialdemokrate. Limaj ka

kursin e saj evropian. "Shihni këta oponentët tanë si po dalin rrugëve me megafon e me shirita të kuq që janë shenjë e komunizmit, shenjë e regjimeve totalitare. Më 14 shkurt të gjithë duhet ta kuptojnë se Kosova nuk mbështet mentalitetin komunist, por e mbështet mentalitetin zhvillimor evropian që përfaqësohet nga LDK-ja", ka deklaruar Hoti. Ai ka folur edhe programin e kësaj partie në zgjedhje, duke u zotuar se qeveria e re do ta vazhdojë mbështetjen për Komunën e Obiliqit. Hoti ka kërkuar nga të gjithë që, më të bashkuar se kurrë, t'i japin mbështetje LDK-së në zgjedhjet e 14 shkurtit.

### Hoxhaj kërkon votën e qytetarëve të Ferizajt për PDK-në

**FERIZAJ, 8 SHKURT (ER)** - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës



jemi në PDK, në kundërshtim me ata që janë në garë me neve, e që do t'i lëmë jashtë garës, është se ne kemi qenë në anën e drejtë të historisë, të tjerët kanë qenë në anën e gabuar të historisë. Albin Kurti ka kundërshtuar marrëveshjen e Ramubjesë. Ai ka kundërshtuar pakon e Ahtisarit, demarkimin me Malin e Zi, ai ka kundërshtuar marrëveshjen e Uashingtonit. Pas 20 vjetësh prapa qytetarët e Kosovës duhet ta kuptojnë se për këtë do të votojnë. A do të votojnë për dikë që i beson Amerikës, apo për dikë që i beson dikujt tjetër?", ka thënë Hoxhaj.

### Kurti, Osmani dhe Glauku në Dardanë bëjnë thirrje për referendum më 14 shkurt

**Dardanë, 8 shkurt (ER)** - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidat për kryeministër, Albin Kurti, bashkë me Vjosa Osmani, me kandidatët për deputetë, Glauk Konjufca, Hydajet Hyseni dhe Tinka Kurti, vizituan të hënën Komunën e Dardanës. Zyrtarët e kësaj partie kanë theksuar se sa më shumë po i afrohen datës së referendumit aq më shumë po i afrohen fitores historike. Kurti e Osmani kanë bërë thirrje që të gjithë bashkë do ta bëjnë ndryshimin e madh i cili ka vetëm një numër e ai numër është 127 dhe ka vetëm një emër,

Vetëvendosje. "Kamenica, e gatshme për ndryshim. U zotuar se me një shumicë parlamentare që do ta marrë besimin më 14 shkurt do ta bëjmë të mundshme një perspektivë, në të cilën shteti është, përveç se garantues, edhe lehtësues i jetës së qytetarëve!", ka thënë Osmani.

kompanitë "Green House" dhe "Mabeko Group". "Puna dhe vullneti i kompanive 'Green House' dhe 'Mabeko Group' nga Peja, na nderojnë si shtet që sytë i ka drejt një të ardhme ekonomike stabile. Këto kompani janë dëshmi që Kosova ka potencial eksporti edhe në vendet më të mëdha evropiane.



mbajtur tubim elektoral edhe në Mitrovicë, ku ka marrë përkrahje për zgjedhjet e 14 shkurtit.

### Hoti: Kosova nuk do ta përkrahë mentalitetin komunist më 14 shkurt

**OBILIQ, 8 SHKURT (ER)** - Kandidati i LDK-së për kryeministër, Avdullah Hoti, ka thënë të hënën, në tubimin elektoral në Obiliq, se LDK-ja është alternativa e vetme që e ruan shtetin e Kosovës dhe

(PDK), njëherësh kandidat për kryeministër, Enver Hoxhaj, ka mbajtur tubim me veteranët në Ferizaj, ku ka shpalosur planin e PDK-së për rimëkëmbje ekonomike, politike dhe kombëtare. Hoxhaj ka theksuar se letra e presidentit të ShBA-së, Joe Biden, drejtuar presidentit serb, ku i kërkon Serbisë njohjen e Kosovës, dëshmon se PDK-ja ka qenë gjithmonë në anën e duhur të historisë, ndërsa të tjerët në anën e gabuar. "A e dini çka tregon kjo? Kjo tregon se na çka




### Haradinaj: Kosova brenda pesë vjetëve ose do të jetë anëtare e NATO-s ose e bashkuar me Shqipërinë

**PEJË, 8 SHKURT (ER)** - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), njëherësh kandidat për president, Ramush Haradinaj, ka vazhduar fushatën elektorale në Pejë dhe Istog. Haradinaj në Pejë ka vizituar

Programi i Aleancës ka strategji konkrete për përkrahjen e ndërmarrësve tanë, që janë shtylla kryesore ekonomike e Kosovës", ka deklaruar Haradinaj. Ndërkaq në takimin me qytetarët e Istogut, Haradinaj ka theksuar se njohja e ndërsjellë me Serbinë do të bëhet pa asnjë kompromis. "Kosova brenda pesë vjetëve ose do të jetë anëtare e NATO-s ose e bashkuar me Shqipërinë", ka thënë Haradinaj.



# Marrëveshja ShBA - Kosovë krijon vende pune



**PRISHTINË, 8 SHKURT** - Marrëveshja për nxitjen e investimeve ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi më 3 shkurt, do ta mundësojë ndërtimin e autostradës Prishtinë - Merdar dhe linjës hekurudhore Beograd - Prishtinë, tha ministri në detyrë i Infrastrukturës në Kosovë, Arban Abrashi, duke shtuar se do të krijohen edhe vende të reja të punës. Investimet amerikane burojnë nga takimi për normalizim ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ku u nënshkruan dy dokumente, më 4 shtator në Shtëpinë e Bardhë, në Uashington, në prani të presidentit të Shteteve të

Bashkuara, Donald Trump. Dokumentet parashihnin investime të Korporatës së ShBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar Financiar, e njohur me shkurtesën DFC, dhe organizatave të tjera financiare amerikane në këto dy vende. Kurse më 31 dhjetor të vitit të kaluar, kjo korporatë, për ta sjellë gamën financiare në Kosovë, ka nënshkruar një marrëveshje me ambasadorin amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, dhe kryeministrin në detyrë, Avdullah Hoti. Korporata për Zhvillim Ndërkombëtar Financiar (DFC) të enjten, më 4 shkurt, ka njoftuar se ka hyrë në fuqi marrëveshja për nxitjen e investimeve që ka arritur me Kosovën.

## Abrashi: DFC-ja, mundësi për bizneset private

Ministri në detyrë, Abrashi, i tha "Radios Evropa e Lirë" se, përveç ndërtimit të autostradës dhe hekurudhës, hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje ka rëndësi të veçantë sepse do të përkrahë sektori privat përmes produkteve financiare. "Mundësitë për financim të bizneseve e projekteve përmes qasjes në fondet e DFC-së do të jenë një nxitje e mundësi e shkëlqyer për ndërmarrësit kosovarë që do të ndikojnë në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të vendit dhe në krijimin e vendeve të reja të punës", tha ai.

Autostrada Prishtinë - Merdar, e gjatë 27 kilometra, e njohur

ndryshe edhe si "Autostrada e Paqes", është një nga projektet e përfshira në Marrëveshjen e Uashingtonit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe kushton përafërsisht 200 milionë euro. Kurse segmenti hekurudhor Prishtinë-Merdare, me gjatësi prej 45 kilometrash, arrin në 150 milionë euro. DFC-ja është bankë e zhvillimit të Amerikës, e cila bashkëpunon me sektorin privat duke financuar zgjidhjet e sfidave më kritike me të cilat përballet bota në zhvillim. DFC-ja investon në sektorë duke përfshirë energjinë, kujdesin shëndetësor, infrastrukturën kritike dhe teknologjinë. Po ashtu, DFC-ja siguron financim për bizneset e vogla dhe gratë sipërmarrëse, me qëllim krijimin e vendeve të

punës në tregjet në zhvillim.

**Zeka: Zbatimi i marrëveshjes së DFC-së, efekt pozitiv tek investitorët e huaj**

Arian Zeka, drejtor ekzekutiv në Odën Ekonomike Amerikane të Kosovës, tha se nisja e zbatimit të marrëveshjes së DFC-së, do të ndihmojë sektorin privat që të ketë qasje në financa. "Këto janë produkte financiare, janë instrumente financiare, ngjashëm sikur çdo institucion tjetër financiar, të cilat u jepen bizneseve, në këtë rast u jepen bizneseve që të investojnë në Kosovë ose t'i zgjerojnë investimet e tyre në Kosovë dhe rajon", tha Zeka.

Ai theksoi se kjo marrëveshje efekte pozitive do të ketë edhe tek investitorët e huaj, të cilët më lehtë do të vendosin që kapitalin e tyre ta shtrijnë në Kosovë. "Pashmangshëm se po, pasi ngjashëm sikur me institucionet e tjera financiare, siç është rasti me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, investitorët mund të gëzojnë qasje alternative në financa", theksoi ai.

Kjo marrëveshje, shtoi Zeka, përfshin edhe financim të borxhit, investime në ekuitet, sigurim të riskut politik dhe grante në ndihmën teknike.

Më 31 dhjetor zëvendëshefi i DFC-së, njëherësh drejtor menaxhues për Ballkanin Perëndimor, John Jovanović, deklaroi se DFC-ja sheh "potencial të madh për të ndihmuar në mobilizimin e investimeve që krijojnë vende pune dhe mbështesin zhvillimin për popullin e Kosovës". Si pjesë e marrëveshjes së Uashingtonit, DFC-ja ka hapur zyrën rajonale në Beograd.

## KEDS-i lanson uebin e ri

**PRISHTINË, 8 SHKURT (ER)** - KEDS-i ka lansuar të hënën uebin e ri që ofron plot risi për konsumatorët dhe qytetarët e vendit sa iu përket çështjeve të energjisë elektrike. Uebi i ri ka dizajn bashkëkohor dhe ofron qasje të lehtë për të gjithë publikun.


Qysh në fillim janë të shënuara të gjitha kanalet e komunikimit me KEDS-in. Kjo është bërë me qëllim që konsumatori të informohet për ndonjë të papritur dhe të udhëzohet nëse ka nevojë të raportojë për ndonjë emergjencë apo ndonjë keqpërdorim. Risi mjaft e rëndësishme

paraqet fakti që konsumatorët do të shohin në ballinë hartën e punimeve të planifikuara në rrjet, ku përmes pamjes vizuale konsumatorët mund ta kuptojnë shumë më lehtë dhe shpejt a ka planifikuar kompania ditëve në vijim punime në rrjet, që bëhen për t'i avancuar shërbimet që ata marrin.

Po ashtu, në ballinë, të gjithë qytetarët mund ta marrin formën e aplikimit dhe t'i gjejnë të gjitha udhëzimet për hapat që duhet për t'u bërë konsumator i ri në KEDS.

Të njëjtën kohë aty janë të publikuara të gjithë tenderët e hapur të KEDS-it për prokurime

të ndryshme, ku kompanitë e interesuara mund të marrin detaje të rëndësishme për t'i përgatitur ofertat e tyre. "Gjithashtu, ne kemi shtuar edhe pyetjet e shpeshta për të ndihmuar çdo konsumator të marrë përgjigjet në pyetjet që ju interesojnë brenda një kohe shumë të shkurtër. As aktivitetet për komunitetin nuk mungojnë dhe qytetarët tani nëpërmjet rubrikave të veçanta kanë mundësi të njoftohen për çështjet tejet të rëndësishme për shoqërinë, për të cilat kompania jonë ngre zërin vazhdimisht", theksohet në njoftimin e KEDS-it.





# Qeveria e re duhet të formojë një trup të veçantë për partneritetet me Izraelin

Njohësi i zhvillimeve ekonomike në vend, njehëresh sekretar i përgjithshëm në Forumin Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor në Trieste, Safet Gërxhaliu, ka thënë se qeveria e re duhet ta formojë një trup të veçantë për partneritetet me Izraelin, pra një trup politik, ekonomik dhe kulturor, në mënyrë që këtë partneritet ta promovojë në masë enorme edhe për shtetet e tjera që nuk e kanë njohur Kosovën

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 SHKURT - Njohësi i zhvillimeve ekonomike në vend, njehëresh sekretar i përgjithshëm në Forumin Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor në Trieste, Safet Gërxhaliu, ka folur për marrëdhëniet e vendosura diplomatike në mes të Kosovës dhe Izraelit dhe përfitimet ekonomike që mund të ketë shteti ynë. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se marrëveshja e Uashingtonit më 4 shtator ishte një nga pikat më të mëdha në shumë aspekte. "Duhet të kuptohet se ajo marrëveshje ka në vete parimet e saj. Çdo parim duhet të shndërrohet në marrëveshje. Në këtë drejtim ka qenë edhe marrëveshja për krijimin e marrëdhënieve ekonomike me Izraelin, që në aspektin ekonomik është i pakontestuar, kurse në aspektin strategjik është

i dizajnuar mirë. Në aspektin e promovimit të Kosovës është vërtet një mekanizëm që duhet të promovohet. Në këtë drejtim duhet t'i jemi mirënjohës ShBA-së për këtë ndihmë", ka thënë Gërxhaliu.

Ai ka theksuar se nëse diçka e ka karakterizuar vitin 2020-2021, është nënshkrimi i marrëveshjes në Uashington dhe vënia e marrëdhënieve diplomatike me Izraelin që është një superfuqi ekonomik. "Për ta ilustruar këtë superfuqi po them vetëm një fakt. Në vitin 2020, derisa Kosova me shumë mund e kaloi në Kuvend buxhetin prej 2 miliardë e 430 milionë eurosh, Izraeli e miratoi buxhetin prej 121 miliardë eurosh dhe orientimin e ka në dije, në inovacion, teknologji inovative dhe ngritje të resurseve humane. Ky është një model që duhet të ndiqet. Besoj se është obligim moral i qeverisë së re që ta formojë një trup të veçantë për partneritetet me Izraelin, pra një trup politik,



ekonomik dhe kulturor, në mënyrë që këtë partneritet ta promovojë në masë enorme edhe për shtetet e tjera që nuk e kanë njohur Kosovën", ka thënë Safet Gërxhaliu, sekretar i përgjithshëm në Forumin Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor në Trieste. Republika e Kosovës më 1 shkurt ka lidhur raporte diplomatike me shtetin e Izraelit. Vendosja e marrëdhënieve është bërë në një

ceremoni solemne virtuale, ku ministrat e jashtëm të dy vendeve kanë nënshkruar dokumentin në të cilin thuhet se të dy shtetet vendosin marrëdhënie diplomatike, me qëllim që ta rrisin bashkëpunimin në shumë sfera. Në dokumentin e nënshkruar shtetet zotohen të bashkëpunojnë në shumë sfera. "Të udhëhequr nga vullneti i përbashkët për t'i promovuar

dhe forcuar lidhjet miqësore, si dhe për t'i zgjeruar horizontet e bashkëpunimit mes dy vendeve dhe bazuar në parimet universale të ligjit ndërkombëtar, duke riafirmuar përkushtimin e përbashkët për ta forcuar bashkëpunimin e frytshëm në sferën politike, ekonomike, të tregtisë, teknike e kulturore dhe në sfera të tjera të interesit të përbashkët (Kosova dhe Izraeli), kanë vendosur që të themelojnë marrëdhënie diplomatike në nivel ambasadorësh", thuhet në dokumentin të cilin e nënshkruan kryediplomatët e Kosovës dhe të Izraelit.

Dokumenti i nënshkruar për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike u nënshkrua në katër kopje: në gjuhën shqipe, angleze, hebreje dhe serbe. Në këtë ceremoni mori pjesë edhe i dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin, Matthew Palmer. Në dokument, po ashtu, thuhet se aspektet teknike të këtij vendimi, përfshirë edhe akreditimin e ambasadorëve respektivë, "do të jenë objekt i diskutimeve të mëtejme përmes kanaleve normale diplomatike". Ambasadorja e Kosovës në Izrael do të jetë Ines Demiri, e cila më 2020 ishte emëruar e ngarkuar me punë në po këtë shtet. Dy ministritë, po ashtu, nënshkruan memorandum për konsultime politike dhe memorandum për bashkëpunim zhvillimor. Që të dy këto memorandume ishin të shkruara në gjuhën angleze.

## Hoti: Tregu financiar në Kosovë nuk është në nivelin që duhet të jetë

PRISHTINË, 8 SHKURT (ER) - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, ka zhvilluar të hënën në mëngjes takim pune me përfaqësuesit e odave ekonomike dhe të bizneseve, të cilët i ka njoftuar gjerësisht rreth përfitimeve nga marrëveshja për nxitje të investimeve. "Është një mundësi e jashtëzakonshme për ta financuar zhvillimin ekonomik të Kosovës në vitet që vijnë. Po hapet një dritare e re. Sektorët nuk janë të kufizuar. Sigurisht pjesa e sektorit publik do të jetë kryesisht në infrastrukturë, në energji, në ambient, në broadband network dhe në gjëra të tilla, por në sektorin privat vetëm qielli është kufizim. Çfarë t'ju bjerë ndërmend, vetëm duhet të ketë kuptim biznesor dhe ekonomik projekti që e financojnë", ka deklaruar kryeministri Hoti. Ai saktësoi rëndësinë e financimit në formë të kredive që mund ta marrin qeveria, institucionet publike, ato private



dhe kompanitë e ndryshme nga institucionet financiare amerikane. Sipas Hotit, mundësia e dytë është investimi në ekuitet dhe instrumenti i tretë është garantimi i investimeve. "Një instrument që është i ngjashëm me fondin

Kosovar për Garanci Kreditore. Shuma totale për këto projekte initiale shkon në 1 miliardë dollarë me maturitet 25 vjet. Unë besoj se kjo është mundësia më e mirë që e ka pasur Kosova nga viti '99 e këndej për të hapur një dritare të jashtëzakonshme

të zhvillimit afatgjatë", është shprehur Hoti. Ai ka theksuar se tregu financiar në Kosovë nuk është në nivelin që duhet të jetë, për t'i absorbuar të gjitha këto instrumente financiare. Hoti ka paralajmëruar takime në kuadër

të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, për të marrë inputet bashkë me ekspertët ndërkombëtarë dhe Bankën Qendrore që të krijohet korniza e nevojshme ligjore në mënyrë që të funksionalizohen këto instrumente financiare.

## Ministri në detyrë i Bujqësisë vizitoi kampin ushtarak Bondsteel

**FERIZAJ, 8 SHKURT (ER)** - Ministri në detyrë i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka vizituar kampin ushtarak Bondsteel, në të cilin ka bashkëbiseduar me ushtarët në këtë kamp. Gjatë këtij takimi ushtarët amerikanë patën rastin të njoftohen me zhvillimet në sektorin e bujqësisë, punët që janë kryer deri tani si dhe për planet e së ardhmes në këtë sektor. Ministri në detyrë, Mustafa, i informoi të pranishmit se si ai u është qasur sfidave që i ka hasur në bujqësi. "Për një periudhë të shkurtër kohore

arrita ta stabilizoj financiarisht Ministrinë e Bujqësisë, duke eliminuar borxhin që kishte ministria ndaj fermerëve dhe njëkohësisht bëra që fermerët të kenë mjete të sigurta financiare për t'i kryer obligimet që kanë", u shpreh ministri Mustafa, duke shtuar se sfiduese ka qenë periudha e mbylljes shkaku i pandemisë Covid-19 së cilës Ministria iu kundërpërgjigj me pagesë dy herë të subvencioneve. Ministri Mustafa, i ftuar nga komanda në Bondsteel, foli edhe rreth institucioneve dhe popullsisë në Kosovë, që t'i



familjarizojë miqtë amerikanë me Republikën e Kosovës.

Qëllim tjetër i takimit ishte miqësisë dhe partneritetit në zhvillimi dhe thellimi i mes të Kosovës dhe ShBA-së.

## Kryeprokurori Kadriu priti në takim përfaqësues të OSBE-së



**GJILAN, 8 SHKURT (ER)** - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, Arben Kadriu, ka pritur në takim përfaqësues nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), me mision në Kosovë, Burim Blakaj, zyrtar i lartë ligjor dhe Milica Stojanovic, zyrtare ligjore vendore. Në këtë takim u

diskutua përkrahja e misionit dhe u bisedua vazhdimi i bashkëpunimit në mes dy institucioneve. Fillimisht, përfaqësuesit nga OSBE-ja e uruan kryeprokurorin për pozitën e re dhe çmuan lart bashkëpunimin evazhdueshëm me Prokurorinë Themelore në Gjilan, duke vlerësuar punën dhe të arriturat e kësaj

prokurorie, si dhe përmendën aktivitetet të cilat OSBE-ja planifikon që t'i implementojë gjatë këtij viti. Në anën tjetër, kryeprokurori Kadriu vlerësoi lart punën e OSBE-së në Gjilan dhe siguroi që ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe më tutje, me qëllim të fuqizimit të efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës.

## Ura në fshatin Lupç të Podujevës është jashtë funksionit

**PODUJEVË, 8 SHKURT (ER)** - Komuna e Podujevës ka njoftuar se ura në fshatin Lupç, në lagjen Murturi, është jashtë funksionit si pasojë e vërshimeve të fundit. "Pas vërshimeve në javët e fundit janë shkaktuar dëme edhe në

infrastrukturë. Ura në fshatin Lupç, në lagjen Murturi, është e pakalueshme dhe jashtë funksionit. Andaj, lusim qytetarët që të shfrytëzojnë rrugë alternative në këtë pjesë kur qarkullojnë", ka njoftuar Komuna e Podujevës.



## Haziri: Rënia e numrit të të infektuarve në Gjilan, lajm i mirë

**GJILAN, 8 SHKURT (ER)** - Numri i rasteve aktive me Covid-19 në Gjilan ka rënë nën 100 dhe ky është lajm i mirë. Komiteti për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së epidemisë së koronavirusit është njoftuar të hënën me gjendjen e përgjithshme të pandemisë në Komunën e Gjilanit, e cila duket kështu në shifra: Të shëruar janë 3 295 persona, të vdekur 108, raste aktive 98, mostra në pritje 100, të spitalizuar 17, gjithsej të testuar janë 9 846, kurse gjithsej

pozitivë deri tani kanë rezultuar 3 500 persona. Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se rënia e numrit të të infektuarve nën 100 është lajm i mirë, por u ka bërë thirrje qytetarëve që të vazhdojnë t'u përmbahen rekomandimeve të profesionistëve shëndetësorë. "Rënia e numrit të të infektuarve dhe i vdekjeve nuk do të thotë që rreziku nga koronavirusi ka kaluar", ka thënë Haziri, duke kërkuar zbatim të masave maskë, distancë dhe higjienë personale.



## Fillon vaksinimi i gjedheve, deleve dhe dhive në Obiliq

**OBILIQ, 8 SHKURT (ER)** - Komuna e Obiliqit ka njoftuar se ka filluar vaksinimi i gjedheve,

deleve dhe dhive në këtë komunë. "Në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë, ka filluar vaksinimi i

gjedheve, deleve dhe dhive. Është viti i katërt që komuna financon një projekt të tillë për t'i

ndihmuar fermerët në kujdesin ndaj kafshëve shtëpiake", ka njoftuar Komuna e Obiliqit.



# Përpyjekje për rishkrim të historisë nga ata që nuk e kanë bërë historinë!



Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA

**Fushata zgjedhore... hajt rrenë hajt:** Nëse për asgjë nuk ia kemi parë hairin pandemisë, atëherë, së paku, na ka shpëtuar nga një fushatë 30-ditëshe. Po e them për fushatë legale sepse ajo ilegjalja pati filluar qëkur u rrëzua qeveria Hoti shkaku i votës së një deputeti që u shpall e pavlefshme. Nëse i dëgjoni premtimet, thuaja pa përjashtim, të gjithë premtojnë rritje të pagave për të gjitha kategoritë e për përmbushjen e këtyre premtimeve duhet një buxhet diku te 4 miliardë euro, gjë që është vështirë të arrihet. Tash mund të flitet për premtime për mbijetesë, ndërsa çdo premtim për rimëkëmbje të shpejtë ekonomike është i barabartë me premtimet e mëhershme për liberalizim të vizave dhe integritim në NATO, BE dhe institucione të tjera ndërkombëtare e që, përkthyer me gjuhën e popullit, nënkupton zëvendësimin e një rrene të vjetër, me një rrenë të re. Po duket se po jetojmë në një kohë kur, ndonëse e kemi të qartë se rrena po qarkullon 24 orë, po i besojmë asaj deri në rrenën e radhës. Prandaj edhe bëjmë pjesë në mesin e popujve më optimistë në botë! Po, si po sillen subjektet politike në fushatë dhe liderët e tyre?

**Albin Kurti dhe LV-ja:** Po bëjnë fushatë agresive, arrogante, nënçmuese dhe përçmuese ndaj partive të tjera garuese dhe liderëve të tyre. Albin Kurti këto zgjedhje po i konsideron si mundësi që t'i diskreditojë të gjithë ata që po marrin pjesë në gara sikur edhe të gjithë të tjerët, që në një mënyrë apo tjetër nuk pajtohen me të. Injorimin ndaj të tjerëve e ka shndërruar në mënyrë të jetesës dhe të veprimt. Për Albinin nuk ka tjetër alternativë përveç Vjosa Osmanit tek e cila nuk gjen asnjë vërejtje dhe të cilën e përdorë si material për një përdorim. Në momentin kur nuk ka nevojë për të, do ta dërgojë për riciklim në kompaninë "Pastrimi", pa Hortikulturë. Albin po e luan lojën që të fitojë më së shumti vota edhe për veten, edhe për partinë. Prandaj nuk e vendosi Glaukun bartës të listës dhe mirë po ia bën. Nuk është hera e parë që i vë

ndërkëmbcën Glaukun dhe ky nuk reagon. Sot Albini e ka shumë më të afërt Vjosën se Glaukun dhe të tjerët: Agresiviteti dhe nënçmimi që ua bënë Albini të tjerëve mund të llogaritet për një përdorim sepse, pas përfundimit të zgjedhjeve, do të vendosë një tjetër standard, do të bëhet qengj, nga të qenit ujk në kohën e fushatës. Në të kundërtën do të përballet me një opozitë, aspak paqësore e që nuk do ta lë të qetë as kur flenë. Këtë Albini e ka të qartë, prandaj do të veshet me lëkurën e qengjit. Në LV nuk ka njeri që ka guxim ta kundërshtojë Komandantin Suprem të LV-së, Albin Kurtin, për faktin se llaskucëria është shndërruar në mënyrë të mbijetesës dhe ndërtimit të karrierës politike. Fuqia e individit apo partisë vlerësohet si sillet ndaj atyre që janë më të brishtë, prandaj mospranimi i debateve është një arrogancë e panevojshme dhe mungesë respekti ndaj atyre që domosdoshmërisht detyroheni të bashkëpunoni me ta, pavarësisht sa vota e merrni dhe cilat poste i kontrolloni. Kosova është një mjedis politik tepër i ngushtë për vetëm një parti politike në pushtet, sidomos kur duhet të merren vendime, aspak të lehta për vendin. Jam i sigurt se këtë e ka shumë të qartë Albin Kurti dhe kori i një numri që e rrethon, i importuar dhe vendor, domosdoshmërisht, pas një kakofonie zhurmuese do t'u përshtatet "tregullave të Albinit". **Avdullah Hoti dhe LDK-ja:** Po e bëjnë fushatën në mënyrë më normale të mundshme. Nuk po fyejnë askënd, po e materializojnë qeverisjen që e kanë për ta rritur numrin e votave. Askush nuk mund ta akuzojë LDK-në dhe partnerët me të cilët ende qeverisin (në detyrë) se e kanë menaxhuar keq pandeminë, përkundrazi besoj se e kanë menaxhuar më mirë se shtetet e rajonit përkundër mundësive të kufizuara, materiale, logjistike dhe profesionale. Ta mbash nën kontroll situatën e shkaktuar nga pakënaqësitë e shumta (të arsyeshme), nuk është aspak e lehtë. Kjo qeveri, edhe në detyrë ka arritur ta bëjë këtë! Çka do të bëjë qeveria në ardhje, do ta shohim! Gabimi i madh që e ka bërë LDK-ja gjatë fushatës është se është marrë shumë me Vjosën dhe me këtë vetëm e ka faktorizuar në vend se të mos merrej fare me të, janë ndarë dhe rrugë e mbarë! Pastaj, kanë reaguar, pa asnjë nevojë në deklaratat e një delikuenti seksual, më parë anëtar i LDK-së, kurse tani anëtar i LV-së. Pastaj, ka

harxhuar kohë me Fatos S-Pecin të cilin e ka bërë fytyrë publike, në vend se ta lënë krejtësisht anash. Qeveria Hoti ishte me fat që përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të sponsorizuara nga "miqtë" e Albinit, Grenell dhe Trump e që u përkrahën 100 për qind nga administrata e Bajdenit dhe vetë Bajdeni, siguroi një tranzicion që mohohet nga Albini dhe LV-ja. Qeveria Hoti ishte mirë me Trampin sikur që është mirë edhe Bajdenin duke siguruar një kredibilitet ndërkombëtar. Edhe me BE-në nuk qëndron keq. Për hir të korrektesisë duhet të thuhet se qeverinë Hoti nuk e ka rrëzuar vota e Etem Arifit, por votat e munguara nga LDK-ja dhe AAK-ja. Fushatën e LDK-së, hiç këtu premtimet për të cilat duhet buxheti 4-5 miliardë euro, e vlerësoj si korrekte e cila nuk nxit tensione.

**Enver Hoxhaj dhe PDK-ja:** Për PDK-në janë rrethana të jashtëzakonshme shkaku se themeluesit e saj janë grabitur nga Gjykata Raciste Speciale në ndërkohë nuk patën mundësi e as kohë ta ndërtojnë dhe stabilizojnë strukturën udhëheqëse të partisë. Madje nëse kemi parasysh dëmet që ia ka shkaktuar Gjykata Speciale Raciste, PDK-ja ka bërë mrekulli që nuk ka rënë në koma politike. Nuk mbahet mend që PDK-ja ka qenë më aktive në terren sikur që ka bërë hapa edhe në punë me diasporën. Hapa të vegjël që do t'i ndihmojnë në të ardhmen. Kam përshtypje që angazhimi i PDK-së më shumë po bëhet për zgjedhjet e ardhshme lokale se për këto të jashtëzakonshmet. Enver Hoxhaj po bën gabim në hapa duke e sfiduar për debat Albin Kurtin në kohën kur Albini më shumë po merret me Enver Hoxhën (përmes mercenarëve) e vdekur nga Shqipëria se me Enver Hoxhën e gjallë nga Kosova. Enver Hoxhaj është virtuoz me fjalorin që po e përdorë, i vesh rrobat pa xhepa, ndërsa e kërcënon Albin Kurtin se e fut në xhep të vogël! Votuesit më të fuqishëm të partive kundërshtarë të PDK-së për këto zgjedhje janë: kryexharrahu i xharrahëve në Gjykatën Speciale Raciste, Jack Smith dhe kryehëqësi i kokave politike, Nikolas Gijotina, mendermethënë, gjykatës i procedurës paraprake që vepron, jo sipas procedurave të një gjykate të drejtë por, sipas procedurave të zbatimit të një urdhërese politike.


**Ramush Haradinaj dhe AAK-ja:** AAK-ja është e përbetuar që Ramush Haradinaj të bëhet president, qoftë edhe me emrin Vjosa Osmani. Për bindjen time po e bën një fushatë të

përqendruar në problemet aktuale dhe reale. Luftën e brendshme me subjektet e tjera politike e ka zhvendosur në një adresë të duhur ku edhe kërkohet zgjidhja e problemit; në luftë me Serbinë fashiste dhe presidentin e saj çetnik, Aleksandar Vuçiqi. Ramush Haradinaj për postin e presidentit po ofron mallin më të kërkuar dhe më efikas në Ballkan, forcën. Ramushi e ka forcën sikur që e ka edhe atë që nuk e kanë anëtarët më të rinj të LV-së, e ka guximim dhe me të drejtë mund të thotë GUXOJ. Figurat kryesore të AAK-së, Ramushi dhe Dauti, po tregohen shumë të kujdesshëm me Albinin dhe LV-në. Vetëm sa nuk po i dërgojnë mesazhe dashurie. Sigurisht për faktin se është shumë afër Shën Valentini, Dita e të Dashuruarve. Se sa janë të sigjerta këto ndjenja, do ta shohim në mbrëmjen e 14 shkurtit!

**Fatmir Limaj dhe Nisma:** Fushatën, në takim me votuesit, po e udhëheqin vetëm dy persona: Fatmir Limaj dhe Bilall Sherifi, kurse armën më të fuqishme rrjetet sociale ia kanë besuar Zafir Berishës. Bilall Sherifi edhe me fe e ka pasur detyrim t'u drejtohet besimtarëve, dikur fetar, kurse tani besimtarëve politikë. Fatmir Limaj merret fort me Enver Hoxhajn të cilin po përpiket ta shndërron në kuti votimi e që e ka shumë gabim. Asnjë votë e PDK-së nuk shkon në kuti të Fatmir Limajt. Zoti e bëftë hair dhe Zoti ua shtoftë gjajretin!

**Rishkrimi i historisë përmes pastrimit të dosjeve:** Pas thyerjeve të mëdha historike dhe politike, ata që e marrin pushtetin, puna e parë është përpjekja për rishkrim të historisë përmes spastrimit të dosjeve; i kriminalizojnë dosjet e kundërshtarëve, kurse i zbukurojnë dosjet e veta ndonëse kanë qenë shumë të ndyra. Dosjet edhe mund të fshihen, por kujtimet dhe dëshmitë e kohës kurrë! Albin Kurti dhe LV-ja, sipas disa medieve, kanë filluar të pastrojnë faqen e LV-së nga "mëkatet e së kaluarës". Thuhet se tash Ibrahim Rugova është krejt tjetër person sikur edhe Konferenca në Rambuje. Deklaratat për presidentin Bajden janë fshirë, është tani një kohë tjetër. Sigurisht se edhe të tjerat. Realisht, mendoj se veprimet e LV-së në të kaluarën nuk paraqesin turp, prandaj nuk duhet t'i nënshtrohen amnezisë (harresës) kolektive. Mund të jenë të gabuara, nga perspektiva e sotme, por jo nga retrospektiva e kohës kur kanë ngjarë. Pse të hiqet dorë nga Konferenca e Rambujesë? Bombardimet e

NATO-s nuk erdhën si pasojë që pala kosovare e nënshkroi marrëveshjen, por se pala serbe nuk e nënshkroi këtë marrëveshje, e cila, sipas meje, ishte dhuratë e Zotit për Serbinë. Pse të shlyhen vlerësimet për personalitete historike, politike, kombëtare apo edhe për proceset, bartës të të cilave kanë qenë këto personalitete, në kuptimin pozitiv apo negativ. Mjafton të pranohet se ai vlerësim ka qenë i gabuar. Albin Kurti dhe LV-ja mund ta shkruajnë historinë vetëm nga dita kur e marrin pushtetin ndërkaq, për të kaluarën kanë qenë sfidues i proceseve historike dhe politike. Edhe unë kam qenë i tillë! Është e vërtetë se Albin Kurti, me përpjekje për rishkrim dhe rishkrim të historisë, po bën gabime të cilat më vonë përsëri do t'i shlyejë. Po mundohet që Adem Demaçin ta zëvendësojë me Ibrahim Rugovën, kurse Adem Jasharin me Vjosa Osmanin, ndonëse këto figura e përjashtojnë njëra-tjetrën. Adem Demaçi nuk mund të zëvendësohet nga askush për faktin se jeta dhe vepra e tij ishin unike. Mund të ketë shqiptarë e të kalojë në burg edhe 40 vjet, por nuk mund të bëhet Adem Demaç. Ibrahim Rugova ishte person që e vulosi një periudhë historike të quajtur rezistencë paqësore. Se si e bëri, është çështje për të diskutuar! Adem Jashari është i papërsëritshëm. Askujt historia nuk do t'i japë një mundësi që e pati dhe e shfrytëzoi, deri në vetëflijin, Adem Jashari. Në planin e sakrificës personale dhe familjare, nuk ka të tillë sikur që ishin Baca Adem Demaçi dhe Adem Jashari. Albin Kurti dhe LV-ja nuk duhet të distancohen nga e kaluara. Duhet të krenohen. Gjithashtu, nuk duhet të kenë frikë nga e kaluara, duhet të kenë frikë nga e tashmja dhe sidomos nga e ardhmja, varësisht si punojnë! Albin Kurti nuk mund ta luajë rolin e Feniksit dhe të ringritet nga hiri i Adem Demaçit. Duhet të digjet vetë dhe të ringritet nga hiri i vet: Albin Kurti nuk mund të shndërrohet në personalitet kombëtar, historik dhe politik duke depersonalizuar figurat e përjetshme dhe të papërsëritshme siç ishin dhe janë, Baca Adem Demaçi, Adem Jashari dhe, për një periudhë, Ibrahim Rugova. Për këtë Avdullah Hoti kishte plotësisht të drejtë kur tha se: "dikush, Albini dhe LV-ja po e shlyejnë të kaluarën kurse ne, LDK-ja, krenohemi me të kaluarën". Sa më shumë të bëni përpjekje të ikni nga e vërteta, ajo bëhet hija juaj e që ju përcjell, deri në theqafje, kur as hija më nuk ju duhet! Sepse, edhe vetë bëheni hija e dikujt!



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Nika: Prishtina, e gatshme ta eliminojë Dritën

Prishtina dhe Drita sot (e martë) e ndajnë “mejdantin” në kuadër të 1/8 së Kupës. Kryeqytetasit janë të përgatitur që pas triumfit në Superkupë ta mposhtin skuadrën kampione edhe një herë tjetër dhe ta eliminojnë nga gara e Kupës. “E gjithë skuadra është e përgatitur për këtë ndeshje. Jemi të vetëdijshëm se është një ndeshje e rëndësishme. Duhet ta japim maksimumin për të kaluar në raundin tjetër. Besoj se me angazhim dhe me fokus të lartë do t’ia dalim ta mundim Dritën, e cila ka skuadër të fortë”, ka thënë Ardit Nika, portier i Prishtinës



## Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 8 SHKURT** - FC Prishtina është e përgatitur që t’ia shkaktojë edhe një humbje skuadrës së Dritës dhe të kualifikohet më tutje në garën e Kupës. Kryeqytetasit janë sot (e martë) mirëpritës në stadiumin “Fadil Vokrri” të kampioneve aktualë të Superligës në kuadër të 1/8 së finales së Kupës. Portieri Ardit Nika për gazetën “Epoka e re” ka thënë se skuadra gjilanasë është mjaft e fortë, por Prishtina është e përgatitur dhe me përqendrim maksimal do ta eliminojë Dritën nga Kupa. “E gjithë skuadra është e përgatitur për këtë ndeshje. Jemi të vetëdijshëm se është një ndeshje e rëndësishme. Duhet ta japim maksimumin për të kaluar në raundin tjetër. Besoj se me angazhim dhe me fokus të lartë do t’ia dalim ta mundim Dritën, e cila është skuadër e fortë. Përparësitë tona janë se luajmë në fushën tonë dhe e njohim më mirë terrenin. Shpresoj të ecë gjithçka siç duhet dhe të vazhdojmë tutje”, ka thënë portieri Nika.

Prishtina ditë më parë e ka mposhtur Dritën në kuadër të finales së Superkupës, e cila është zhvilluar në Antalia të Turqisë. Për dallim nga Prishtina, kampionia ua ka “mbyllur” gojën futbollistëve para ndeshjes ndaj kryeqytetasve. Një nga futbollistët e skuadrës kampione ka konfirmuar për gazetë se klubi ka marrë vendim që futbollistët mos të deklarohen për media. “Më vjen keq, por nuk kemi të drejtë të deklarohejmë për media. Është vendim i klubit dhe natyrisht se duhet të respektohet”, ka thënë futbollisti që nuk dëshoi t’i përmendet emri në gazetë. Ndeshja e 1/8 së finales së Kupës në mes të Prishtinës dhe Dritës zhvillohet sot (e martë) në stadiumin “Fadil Vokrri” me fillim nga ora 13:00.

## Drejtuesit e Llapit i motivojnë futbollistët

Skuadra e Llapit në kuadër të 1/8 së finales së Kupës do të përballet me Ballkanin nga Suhareka. Në stërvitjen e fundit para kësaj ndeshje që zhvillohet të martën në stadiumin

“Zahir Pajaziti”, të pranishëm ishin drejtuesit e klubit për t’i motivuar futbollistët para kësaj ndeshje shumë të rëndësishme. “Të pranishëm në stërvitjen e fundit para ndeshjes së 1/8 së Kupës së Kosovës ndaj Ballkanit për t’i dhënë mbështetje të fuqishme skuadrës për kualifikimin tutje ishin: kryesia e klubit, presidenti Beqir Batatina, zëvendës-presidenti Amrush Batatina dhe drejtori ekzekutiv Bejtush Batatina. Ne jemi të gatshëm për sfidën e Kupës”, thuhet në njoftimin e Llapit.

## Kupa e Kosovës - 1/8 e finales

**Të martën takohen:**  
13:00 Prishtina - Drita  
13:00 Drenica - Ulpiana  
13:00 Llapi - Ballkani

**Të mërkurën takohen:**  
13:00 A&n - Flamurtari  
13:00 Trepça '89 - Ferizaj  
13:00 Istogu - Gjilani  
13:00 Dukagjini - 2 Korriku

## SHKURT

### Jaksi përforcon KB Vëllaznimin

Skuadra e basketbollit, Vëllaznimi nga Gjakova, është përforcuar me Kendall Jacks. Lojtari më i ri i skuadrës kuqezi luan në pozitën 1 dhe 2. “Jacks është përforcimi i radhës në formacionin e klubit dhe luan në pozitat 1-2. Pas dy sezoneve në Portugali, ku kishte performancë të shkëlqyer, Jacks i bashkohet Vëllaznimit dhe priten rezultate pozitive prej tij”, thuhet në njoftimin e klubit kuqezi.

### RB Leipzigu e dëshiron Igli Taren

Drejtori sportiv i Lazios, Igli Tare, edhe zyrtarisht është në listën e skuadrës nga Bundesliga, RB Leipzig, ka njoftuar të hënën sajti italian “Tuttomercatoweb”. Mësohet se Tare po pëlqehet shumë nga ekipi gjerman i cili e sheh si pjesë të rëndësishme për edicionin e ardhshëm pasi te Leipzigu po përgatitet një projekt i madh që pritet të jetë i suksesshëm për të ardhmen. Tare është në rolin e drejtorit sportiv te Lazio prej vitit 2008 dhe ka impresionuar me punën e kryer tek ekipi nga Seria A. Puna e tij fantastike sa i përket skautimit dhe transferimit të lojtarëve ka bërë që Leipzigu ta shohë Taren kandidat potencial për drejtor sportiv. Thuhet se Leipzigu së shpejti pritet ta kontaktojë Lazion në lidhje me Taren pasi është në kërkim të një drejtor sportiv për sezonin tjetër.

### Shaqiri, pas formës së dobët të Liverpoolit: Ne nuk jemi robotë

Xherdan Shaqiri thotë se rënia e formës së Liverpoolit nuk duhet të shihet si një tragjedi dhe insiston se ai me shokë nuk janë robotë që mund të jenë gjithmonë në top-formë. Shaqiri beson ende se “Reds” ka mundësi ta fitojë titullin e kampionit përkundër shkëputjes së Manchester Cityt. “Ne jemi si njerëzit normalë që kanë ngritje dhe rënie. Kjo është normale. Ne nuk jemi robotë që mund të jenë gjithmonë në 200-përqindëshin e tyre”, ka deklaruar Shaqiri për “Daily Mail”. “Ekipet e Premierligës janë të mira, madje edhe me ekipe të vogla është e vështirë të luash. Ekipet e mëdha janë gjithmonë të forta. Jo vetëm ne. Ndoshta ne i kishim disa lojë ku nuk luajtëm mirë. Edhe ekipet e tjera të mëdha nuk ishin në formë solide këtë sezon. Ne jemi ende atje, në Top 3 ose Top 4, kështu që nuk mund të ankohejmë sikur të ishte shumë keq. Unë e shoh këtë ndryshe nga njerëzit jashtë. Ne jemi njerëz normalë dhe jo robotë, kështu që mund të kemi ndonjëherë momente jo të mira dhe që ekipet e tjera po përmirësohen çdoherë me rezultate dhe kjo është gjë normale në jetë”, ka shtuar futbollisti nga Zhegra e Gjilanit.

## Hamiltoni rinovon kontratën me Mercedesin

LONDËR, 8 SHKURT - Nuk ka më dilema, Lewis Hamiltoni do të vijojë të jetë piloti i Mercedesit në Formula 1. Shtatë herë kampioni i botës ka arritur akordin e rinovimit të kontratës me skuadrën gjermane. 36-

vjeçari anglez ka zgjatur bashkëpunimin me një tjetër vit me Mercedesin. Hamiltoni do ta nisë sezonin e nëntë me këtë skuadër, me objektivin për ta fituar titullin e tetë personal, diçka që nuk e ka arritur asnjë

pilot. "Unë po pres me padurim ta filloj sezonin tim të nëntë me shokët e mi të ekipit Mercedes. Ne kemi arritur rezultate të jashtëzakonshme së bashku dhe shpresojmë të vijojmë me fitore duke vazhduar të

rritemi, si brenda dhe jashtë pistave. I jam mirënjohës skuadrës për mbështetjen. Ndiem krenar për rinovimin. Jam shumë i motivuar dhe mezi po pres marsin për t'u rikthyer sërish në pistë", ka deklaruar



kampioni i madh i Formulës 1 pas publikimit të lajmit zyrtar të rinovimit.

## FC Ballkani: Mos shpifni, asnjë pagë nuk ua kemi borxh futbollistëve

Suharekë, 8 shkurt - Skuadra e Ballkanit ka reaguar ndaj zërave të fundit se ky klub ua ka borxh nga tri paga futbollistëve. Klubi nga Suhareka e ka pranuar se po ka vështirësi me pagesa, sikur shumica e klubeve në Kosovë, por konfirmon se kontratat po respektohen si me futbollistët ashtu edhe me shtabin teknik. "Ditë më parë ka qarkulluar lajmi nëpër disa 'media' dhe 'analistë' se klubi i futbollit FC Ballkani iu ka borxh paga futbollistëve. Pretendohet se futbollistët s'kanë marrë paga tash e tre muaj. Me përgjegjësi



iu përgjigjemi se ky lajm nuk qëndron aspak, jo tre apo dy muaj, por çdo muaj jemi duke i

respektuar kontratat me futbollistët dhe stafin. Është e vërtetë që kemi vështirësi me pagesa, sikur shumica e klubeve në Kosovë apo më gjerë, por assesi nuk do të kemi probleme me pagat dhe pagesat e tjera. Andaj, ju njoftojmë se lajmi për mospagesë të pagave nuk qëndron, të gjitha pagat janë komfor afateve kohore. Një këshillë për 'analistët' tanë, mos shpërndani lajme të pavërteta apo dezinformata, vetëm për interesa të klikimeve apo interesave të tjera personale", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

## FBK-ja falënderon organizatorin e 'Final 8' të Kupës së Kosovës

Prishtinë, 8 shkurt - Nga 3 deri më 7 shkurt palestra "13 Qershori" ka qenë arenë e ndeshjeve të basketbollit të Kosovës, ku është organizuar "Final 8" i Kupës së Kosovës, finalja e Kupës në konkurrencën e femrave dhe Final 4 i Ligës së Parë të meshkujve. Në këto kushte të pandemisë me Covid-19 nuk ka qenë aspak e lehtë që të organizohet një ngjarje e tillë por, falë angazhimit të të gjithëve, një gjë e tillë është mundësuar. Me këtë rast Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) dëshiron t'i falënderojë të gjithë pjesëmarrësit e kësaj ngjarje.



FBK-ja falënderon klubin organizator Golden Eagle Ylli për përpjekjet maksimale që kjo ngjarje të shkojë siç është më së miri. "Një falënderim shkon për të gjitha klubet pjesëmarrëse në garat e Kupës dhe korrektësinë e treguar në këto ndeshje, si dhe për gjyqtarët e ndeshjes të cilët gjatë 'Final 8' të Kupës së Kosovës kanë qenë njëkohësisht të angazhuar në Klinikën e organizuar veçmas për ta, në mënyrë që ndarja e drejtësisë në këtë ngjarje shumë të rëndësishme për FBK-në të jetë

në nivelin më të lartë të mundshëm", thuhet në njoftimin e FBK-së.

Federata e Basketbollit ka falënderuar edhe Policinë e Kosovës, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministrinë e Shëndetësisë për gatishmërinë për të ndihmuar në organizim dhe punën që kanë bërë gjatë gjithë "Final 8". "Ndeshjet do të ishin të mangëta pa transmetimin e partnerit medial 'Kujtesa', që ka mundësuar transmetimin e tyre, në një kohë

kur nuk lejohen tifozët në palestër. Po ashtu, 'Kujtesa' ka realizuar edhe Highlights dhe intervistat pas ndeshjes, duke i përjetuar edhe më shumë këto takime. Gjithashtu, falënderojmë mediat për korrektësinë e treguar dhe raportimin nga dita e parë deri në finale. Edhe pse e kishin të pamundur të ishin në palestër, me shkrimet dhe kronikat u kanë mundësuar lexuesve dhe shikuesve të kuptojnë se çfarë po ndodh në 'Final 8', thuhet në njoftimin e FBK-së.

### SHKURT

#### Hysaj në verë largohet nga Napoli

Kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Elseid Hysaj, do të largohet në fund të sezonit nga Napoli si lojtar i lirë. Klubi i Napolit nuk ka më interes për t'i plotësuar kërkesat futbollistit shqiptar për rinovimin e kontratës, ndaj palët do të ndahen pas një bashkëpunimi gjashtëvjeçar. Pikat mbi "i" i vë përfaqësuesi i shkodranit, Mario Giuffredì. "Rinovimi i Hysajt? Mendon se diskutimi është mbyllur. E dimë që nga sezoni i ardhshëm do të jemi në një skuadër tjetër. Napoli ka ndërmend të përqendrohet në të tjera drejtime. Po bisedojmë me klube të tjera, megjithatë Hysaj do ta bëjë si duhet detyrën e tij deri në qershor. Edhe futbollistë të tjerë duan pagë të lartë, por është dyshimi nëse mund të bëjnë më mirë se Hysaj", ka deklaruar ai. Mediat shkruajnë se interesim për Hysajn kanë shfaqur Olympique Marseille, Lyoni, Sevilla dhe Roma.

#### Kloppi zbulon bisedën që kishte me Alissonin

Alisson Becker është një nga portierët më të mirë në planet, por përballë Manchester Cityt bëri dy gabime që ndikuan në rezultat (1-4). Trajneri Jurgen Kloppi e ka zbuluar bisedën me portierin latin pas humbjes së Liverpoolit nga Manchester City. "I fola për pak sekonda. Natyrisht që ai ishte shumë i zhgënjyer dhe i mërzhitur. Vazhdonte të thoshte: jo sot, vetëm sot nuk duhet të ndodhte... Unë iu përgjigja: ky është problemi i gabimeve. Nuk mund t'i korrigjosh menjëherë pasi i ke kryer. Vetëm mund të mësosh prej tyre. Jam i sigurt që nuk do t'i përsërisë më këto gabime. Ai na ka shpëtuar jetën në shumë raste me pritjet e tij, nuk e di sa herë. Po flasim për një portier të nivelit botëror. I thashë edhe këtë: i sheh stendat? Mund ta gjuash topin atje për t'u shfryrë", ka deklaruar Kloppi.

#### Guardiola lavdëron Sterlingun

Në "Anfield Road" Manchester City i dha një leksion futbollit Liverpoolit duke triumfuar me shifrat e thella 1-4. Trajneri i Cityt, Pep Guardiola, u shfaq i lumtur për këtë fitore, teksa vlerësoi shumë Raheem Sterlingun, autori i golit të tretë. "Të rëndësishme ishin vetëm tri pikët. Natyrisht se jam shumë i kënaqur me faktin që djemtë thyen një rekord që zgjaste prej një kohe të gjatë. Zhvilluam një performancë të mrekullueshme. Komplimente edhe për Raheem Sterling. Ishte i shkëlqyer, njësoj si në ndeshjen e sezonit të kaluar", ka deklaruar Guardiola.

#### Napoli konfirmon lëndimin e Manolasit

Pas rezultimit pozitiv me Covid-19 të Kalidou Koulibaly, listës së problemeve në mbrojtjen e Napolit i është shtuar edhe Kostas Manolas me lëndimin e tij. Napoli konfirmoi në uebfaqen e klubit se Manolas ka pësuar një lëndim në kyçin e djathtë të këmbës dhe koha e rikuperimit vlerësohet të jetë tri javë jashtë fushave të blerta. "Informacionet nga klinika 'Pineta Grande', evidentojnë që një lëndim i shkallës së dytë të ligamentit në kyçin e këmbës së djathtë. Rikuperimi parashihet të zgjasë tri javë. Futbollisti ka filluar procedurat", thuhet në komunikatën e klubit.

## Reali do të ofrojë 100 milionë euro për Lukakun

Zinedine Zidane kërkon të qëndrojë në krye të Realit edhe për sezonin e ardhshëm, por në Madrid duhet një ndryshim i madh, kërkohen lojtarë të rinj

për të freskuar një grup të vjetër dhe që kanë fituar gjithçka në vitet e fundit. Sipas mediave spanjolle, presidenti Perez do të vihet në lëvizje për

të gjetur një sulmues të ri, mes emrave të shumtë në tavolinën e tij ka përfunduar edhe Romelu Lukaku. Reali ka gati një ofertë fantastike, mbi 100

milionë euro për ta bindur klubin zikaltër. Në këtë periudhë të vështirë ekonomike, një shifër e tillë nuk është e lehtë as për një

klub si Reali, por nga Madridi këtë verë priten të largohen disa lojtarë nga ku Perezi pretendon të përfitojë rreth 200 milionë euro.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.264/15

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm,** gjyqtari Malsor Kryeziu, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: 1. Avdullah Berisha, 2. Haxhi Berisha, që të dy nga Gjakova, rr." Fehmi Agani" nr.149, të cilën e përfaqëson Teki Bokshi, avokat nga Gjakova, kundër të paditurve: 1. Komuna e Gjakovës, 2. Vladimir Pavloviq, ish nga Gjakova, tani me banim në Serbi me adresë të pa njohur, me objektin e padisë për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në patundshmëri, vlera e kontestit 4.000 euro, me date.16.06.2020, mori këtë:

#### AKTVENDIM

I. Të paditurit Vladimir Pavloviq, ish nga Gjakova, tani me banim në Serbi me adresë të panjohur, të cilit tani nuk i dihet adresa e saktë, **IAKTOHET** përfaqësuesi i përkohshëm avokati Azem Islamaj, avokat nga Gjakova.

II. Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

III. Ky aktvendim do të shpallet në gazetën zyrtare, në një nga gazetatat e përditshme ditore si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

#### Arsyetim

Paditësve: 1. Avdullah Berisha, 2. Haxhi Berisha, që të dy nga Gjakova, rr."Fehmi Agani" nr.149, përmes të autorizuarit të tyre Teki Bokshi, avokat nga Gjakova, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në patundshmëri, kundër të paditurve 1. Komuna e Gjakovës, 2. Vladimir Pavloviq, ish nga Gjakova, tani me adresë të panjohur në Serbi.

Gjyqtari gjykues pas vlerësimit të shkresave të lëndës ka nxjerrë aktvendim C.nr.264/15, të dt.22.11.2017, me të cilin të paditurit të dytë Vladimir Pavloviq, ish nga Gjakova, tani me adresë të panjohur në Serbi, i ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm Hilmi Hoxha ish avokat nga Gjakova. Gjatë rrjedhjes së procedurës, përfaqësuesi i përkohshëm avokati Hilmi Hoxha ka ndërruar jetë. Në ndërkohë gjykata me aktvendimin procedural të dt.10.09.2018, e ka revokuar aktvendimin C.nr.264/15 të dt.21.11.2017 dhe me të njëjtin aktvendim ka vendosur që ti caktohet përfaqësuesi tjetër pas rekomandimit të OAK-së.

Gjyqtari gjykues pas marrjes së rekomandimit respektivisht emrit të avokat nga ana e OAK-së, duke pasur parasysh se procedura për caktimin e përfaqësuesit ligjor do të zgjatë shumë, e në anën tjetër do të shkaktohet dëme të pa nevojshme paditësit e me qëllim të evitimit të pasojave të dëmshme gjykata caktoj avokatin Azem Islami, nga Gjakova - përfaqësuesi i përkohshëm për të paditurin 2, gjersa ata apo i autorizuari i tij të paraqitet në këtë gjykatë apo gjersa organi i kujdestarisë të njoftojë se ka caktuar kujdestarin.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimin konfrom dispozitave të nenit 79.3 pika a të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
C.nr.264/15 të datës 16.06.2020



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Renelual Tahiri" Sh.p.k Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për plotësimin dhe ndryshimin e koordinatave të trases së vendosjes së gypave, dekantuesit dhe objektit makinerik të hidrocentralit "Orqusha", zona kadastrale Orqusha komuna e Dragashit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 08.03.2021 në ora 13:30 në hapësirat e objektit të Hidrocentral Orqusha - vendi i realizimit të Objektit dhe Projektit në Orqushë komuna e Dragashit do të organizohet debat publik nga kompania "Renelual Tahiri" Sh.p.k Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për plotësimin dhe ndryshimin e koordinatave të trases së vendosjes së gypave, dekantuesit dhe objektit makinerik të hidrocentralit "Orqusha", zona kadastrale Orqusha komuna e Dragashit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM <https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=UmQvcFNUNGQrZVFOM3RnU0d2K283Zz09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Renelual Tahiri" Sh.p.k Prizren për plotësimin dhe ndryshimin e koordinatave të trases së vendosjes së gypave, dekantuesit dhe objektit makinerik të hidrocentralit "Orqusha", zona kadastrale Orqusha komuna e Dragashit.

[https://mea.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

<https://mea.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publicimet/VNM%20Renelual%20Tahiri%20HC%20Orqusha.pdf>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Naim Rr. Elshani" B.I. Suharekë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në vendin e quajtur Rezina komuna e Suharekes.


Njoftohet publiku i interesuar se më datën 10.03.2021 në ora 10:00 në hapësirat e pikës së karburanteve "Flamuri Petrol" Rr. Brigada-123 në Suharekë do të organizohet debat publik nga kompania "Naim Rr. Elshani" B.I. Suharekë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në vendin e quajtur Rezina komuna e Suharekes.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/.81960838496?pwd=aTI3bkNOeDJSU1hKVzI2SHVUcDN1Zz09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.





# Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  [www.facebook.com/gjejepuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejepuneshpejte)

## RESTAURANT



# SWISS

## TAVERNA




Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Andrian Berisha shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Dy Dëshmorët " Serbic e Poshtme.
- ▶ Leutrim Moralija shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Veton Çoçaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf mu " Zenun Çoçaj " Gjonaj.
- ▶ Besë Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.
- ▶ Besë Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën shmm " Luciano Motroni " Prizren.
- ▶ Auto shkolla "Trimi" Gjilan, për nder të festave bënë Zbritje 30% nga 10 deri 20 shkurt2021
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoh një banesë me qera në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

# DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski

ÇMIMI: 5.99 €

ISBN 978-9951-780-37-7

9 789951 780377

ARMAGEDONI

Rrallëherë ndodh qe lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzjegzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve te shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

